

Statistikat e Transportit

Mars, 2017

Tiranë, më 27 Prill 2017: Informacioni statistikor mujor mbi transportin, jep një panoramë të përgjithshme të ecurisë së transportit të mallrave dhe pasagjerëve me ajër, det dhe tokë (përfaqësuar nga transporti hekurudhor).

Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Mars 2017 është 345 mijë/ton. Krahasuar me Mars 2016, ky tregues është rritur me 39,1 %. Në portin e Durrësit janë ngarkuar/shkarkuar 92,8 %, e sasisë së mallrave të ngarkuar/shkarkuar në të gjitha portet.

Tab. 1 Volumi i ngarkim-shkarkimit të mallrave në porte, Mars 2017

000/ton

Periudha	Gjithsej	Durrës	Porte të Tjerë
Mars 2016	248	225	23
Mars 2017	345	320	25
Ndryshimi vjetor (%)	39,1	42,2	8,7
Janar- Mars 2016	775	709	66
Janar- Mars 2017	837	787	50
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	8,0	11,0	-24,2

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë, për kilometër, është rritur 287,1 %, krahasuar me Mars 2016, i ndikuar kryesisht nga transporti ndërkombëtar.

Volumi i mallrave për kilometër, në tremujorin e parë 2017, është rritur 113,5 % në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Tab. 2 Transporti i mallrave me hekurudhë, Mars 2017

Periudha	Volumi i mallrave 000/ ton.km	Volumi i mallrave 000/ ton
Mars 2016	350	2
Mars 2017	1.355	7
Ndryshimi vjetor (%)	287,1	250,0
Janar- Mars 2016	1.552	9
Janar- Mars 2017	3.312	19
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	113,5	111,1

Volumi i mallrave të transportuar me ajër është ulur 1,3 %, në krahasim me Mars 2016. Në tremujorin e parë të 2017, volumi i mallrave të transportuara është rritur 3,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 3 Transporti i mallrave dhe postës me ajër, Mars 2017

Periudha	Mallra ton	Posta ton
Mars 2016	155	43
Mars 2017	153	38
Ndryshimi vjetor (%)	-1,3	-11,6
Janar- Mars 2016	391	129
Janar- Mars 2017	404	112
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	3,3	-13,2

Në transportin ajror operojnë 15 shoqëri fluturimi dhe janë kryer 1.730 fluturime, duke shënuar një rritje me 5,6 %, ndaj Mars 2016.


Tab. 4 Treguesit e transportit ajror, Mars 2017

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Mars 2016	15	1.638	8.780
Mars 2017	15	1.730	8.776
Ndryshimi vjetor (%)	-	5,6	-0,05
Janar- Mars 2016	15	4.790	25.110
Janar- Mars 2017	15	5.104	24.248
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-	6,6	-3,4

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, gjatë këtij muaji është rritur 19,4 %, krahasuar me Mars 2016. Transporti i pasagjerëve zë peshën më të madhe me 76,9 %, në transportin ajror.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 50.419 persona. Krahasuar me Mars 2016, ky tregues është ulur 3,8 %.

Fig. 1 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit



Tab. 5 Transporti i mallrave 2007-2016

000/ton

Vitet	Transporti hekurudhor i mallrave	Transporti detar i mallrave	Transporti ajror i mallrave dhe Posta
2007	399	4.332	4
2008	355	4.705	3
2009	343	4.193	2
2010	403	4.170	2
2011	317	4.067	3
2012	142	3.984	2
2013	151	4.001	2
2014	338	4.067	2
2015	198	3.840	2
2016	76	3.756	2

Tab. 6 Transporti i pasagjerëve, 2007- 2016

000/pasagjerë

Vitet	Transporti hekurudhor	Transporti detar	Transporti ajror
2007	1.091	925	1.107
2008	822	1.080	1.260
2009	645	1.160	1.395
2010	430	1.120	1.537
2011	453	1.166	1.817
2012	448	1.101	1.665
2013	329	1.009	1.757
2014	187	1.095	1.810
2015	189	1.186	1.977
2016	69	1.289	2.139

Metodologji

Përkufizime:

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.